



Nr: 344 Prot
dt: 28.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
FAKULTETI EKONOMIK

Z. I. Hoxha,
Te merrtesh/shtypshesve
Sistem.

28.01.2025

Nr. 92/1 prot.

Shkodër, më 28.01. 2025

**Lënda: Informim për të interesuarit për aplikim në programin e studimit
"Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"**

Rektorit të USH-së

Prof.dr. Tonin Gjuraj

Referuar Urdhërit të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nr. 174 datë 04.04.2022 me subjekt "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm", shkresës me nr. 1232/13 Prot datë 23.09.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, me subjekt "Kthim përgjigje" mbi kuotat dhe udhëheqësit e programit Doktoratë, Vendimit të dekanatit nr 1626 Prot datë 18.12.2024 "Mbi përcjelljen e kriterëve të programit Doktoratë – Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për kuotat e vitit akademik 2023 -2024, ju bëjmë me dije se janë hapur aplikimet në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në **Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm**, i ofruar nga Universiteti i Shkodrës, Fakulteti Ekonomik.

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju dërgojmë:

1. Informim për të gjithë të interesuarit për aplikim në programin e studimit "Doktoratë" në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"

Kërkojmë nga ana juaj publikimin në faqen zyrtare të universitetit për informim për të interesuarit për aplikim në programin e studimit "Doktoratë" në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm

Kjo Shkresë përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë

Dekani

Prof As Dr Elidiana Bashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
FAKULTETI EKONOMIK

Nr. 92 prot.

Shkodër më 28.01 /2025

**Informim për të interesuarit për aplikim në programin e studimit 'Doktoratë'
në 'Ekonomi dhe Turizëm të qëndrueshëm'**

Referuar Urdhërit të Ministrisë së arsimit dhe Sporteve nr. 174 datë 04.04.2022 me subjekt "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm", shkresës me nr. 1232/13 Prot datë 23.09.2024 nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, me subjekt "Kthim përgjigje" mbi kuotat dhe udhëheqësit e programit Doktoratë, Vendimit të dekanatit nr 1626 Prot datë 18.12.2024 "Mbi përcjelljen e kriterëve të programit Doktoratë – Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm", për kuotat e vitit akademik 2023 -2024, ju bëjmë me dije se janë hapur aplikimet në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm, i ofruar nga Universiteti i Shkodrës, Fakulteti Ekonomik.

Objektivat e programit të studimit të doktoratës:

- Të kontribuojë me kërkim shkencor të thelluar në funksion të bizneseve dhe institucioneve publike dhe private për të shërbyer zhvillimit të inovacioneve dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve turistike.
- Të forcojë lidhjet midis biznesit dhe universitetit duke e orientuar kërkimin shkencor në zhvillimet ekonomike dhe prioritetet strategjike të vendit siç është zhvillimi i sektorit të turizmit për ekonomi të qëndrueshme.
- Të ofrojë udhëheqje të fokusuar në zhvillimin dhe eksplorimin e ideve të reja me orientim në krijimin e lidhjeve dhe rrjeteve midis biznesit dhe akademisë.
- Të shërbejë si një model ku kërkimi shkencor kryhet në funksion të zhvillimeve aktuale të vendit dhe duke qenë i dobishëm në risitë e eksploruara për të justifikuar edhe burimet e financimit që e mbështesin atë.
- të përgadisë kërkues/studiuues kompetent që mund të kryejë kërkime të pavarura në fushën turizmit të qëndrueshëm dhe nën fushave të lidhura me të.

Kriteret e pranimit dhe dokumentacioni perkatës: Miratuar me vendim nr.1626 Prot datë 18.12.2024 i Dekanatit të FE "Mbi miratimin e kriterëve të pranimit në programin 'Doktoratë' në Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm" (*Kriteret e pranimit dhe dokumentacioni -Shtojca 1*)

Mënyra e zhvillimit të studimeve Doktoratë: ndërtohet mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushën kërkimore 'Ekonomi dhe Turizëm të

qëndrueshëm' dhe nënfushat e përcaktuara nga njësia bazë dhe të miratuara nga Dekanati i FE me Vendimin nr.13 Datë 29.04.2021 të Dekanatit të Fakultetit Ekonomik (*Fusha dhe Nënfishat kërkimore – Shtojca 2*)

Projektet kërkimore dhe zhvillimore: Në kuadër të programit të Doktoratës 'Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm' janë miratuar për financim 7 projekte kërkimore dhe zhvillimore me vendim Senati Akademik të USH nr.239 datë 22.07.2021 dhe me vendim të Bordit të Administrimit të USH nr.345 datë 17.11.2021 (*Lista e projekteve kërkimore - Shtojca 3*)

Personeli akademik i kategorisë 'Profesor'-udhëheqës shkencor për studentët Doktorant: Mbështetur nga shkresa e MAS nr 2485/5 Prot datë 20.09.2024 (*Lista e stafit akademik-udhëheqës shkencor i Doktorantit - Shtojca 4*)

Kohëzgjatja e studimeve: Ky program zhvillohet me kohë të plotë pranë FE për 3 vjet dhe kohë të zgjatur për 5 vjet kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

Numri i kuotave për këtë program studimi, viti akademik 2023-2024 : 20 (njëzet) studentë.

Modeli i projekt propozimit të kërkimit shkencor për doktorantin: I miratuar me vendimin nr.27 Datë 04.07.2022 të Dekanatit të Fakultetit Ekonomik (*Modeli i projekt-propozimit të kërkimit të Doktorantit - Shtojca 5*)

Formularët për t'u plotësuar e dorëzuar: Formulari i aplikimit për programin e studimit 'Doktoratë' në 'Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm'; Formulari i Vetëdeklarimit të kandidatit për zbatimin e standarteve shkencore dhe etike në programin 'Doktoratë'; Formulari i Deklaratës vetjake të kandidatit për përballimin e shpenzimeve në programin e Studimit 'Doktoratë', të miratuar me Vendim Dekanati të FE nr.31 datë 14.09.2022, i gjeni pranë sekretares së Dekanit të FE.

Afati i aplikimeve dhe i pranimit të dokumentacionit: 28.01.2025 deri 28.02.2025.

Vendi i pranimit të dokumentacionit: Dorëzimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë Sekretares së Dekanit të Fakultetit Ekonomik. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin 9.00-12.00.

Procedura e përzgjedhjes së aplikantëve si studentë Doktorate: fillon pas përfundimit të afatit të aplikimeve dhe zhvillohet në përputhje me rregulloren e programit të studimit Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm"

Tarifa e aplikimit 2000 lek; **tarifa e rregjistrimit** 3000 lek, ndërsa **tarifa vjetore e shkollimit për studimet në Doktoratë** është 150.000 lek (Bazuar në vendimin e Bordit të Administrimit të USH nr.153 datë 23.04.2021).

Për informacione më të detajuara mund të drejtoheni pranë Drejtuesit të Departamentit të Turizmit dhe Kordinatores së këtij programi studimi.

DEKANIA

Prof.as.Dr. Elidiana Dashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
Fakulteti Ekonomik

Dekanati

Nr. 1625 Prot

Shkodër, më 18 . 12 .2024

V E N D I M

Nr 50. datë 18.12.2024

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT NE PROGRAMIN "DOKTORATË"
NE "EKONOMI DHE TURIZËM I QENDRUESHËM", PËR VITIN AKADEMIK 2023-
2024.**

Në mbështetje të:

- Ligjit me Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- VKM nr.824 datë 24.12.2021 'Për miratimin e Kodit të cilësisë në arsimin e lartë';
- VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademike "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", (të ndryshuar);
- VKM nr. 777, date 26.12.2018, "Per kontrollin antiplagjiature të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", (të ndryshuar) ;
- Udhëzimit të MASR nr.1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degeve te tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", (të ndryshuar);
- Udhëzimit të Ministrisë përgjegjëse të Arsimit Nr. 52, datë 3.12.2015 "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë" (të ndryshuar);
- Udhëzimit të MASR nr. 16, date 08.07.2019, "Për paisjen e IALme regjistrin themeltar të studenteve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave";
- Udhëzimit të perbashkët të MASR dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 "Për skemen dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor;
- Udhëzimit të MASR nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e rregjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademike të leshuar në Republikën e Shqipërisë";
- Statutit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës;
- Rregullores së Fakultetit Ekonomik të UNISHK;

- Rregullores së Departamentit të Turizmit në FEUNISHK;
 - Rregullores “Për organizimin e programit të studimit Doktoratë në ‘Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm’, Fakulteti Ekonomik, Universiteti “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës
- Dekanati në mbledhjen e datës 17.12.2024 dhe 18.12.2024 (vazhdim i mbledhjes së datës 17.12.2024) diskutoi mbi kriteret e pranimit, dokumentacionin e aplikimit në programin Doktoratë “Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm” dhe në perfundim

VENDOSI:

Të miratojë. :

- I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u pranuar në programin Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm” për vitin akademik 2023-2024 si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

- a) Të ketë perfunduar studimet e larta dhe te zotërojë të paktën njëren nga diplomatat “Master i Shkencave”, “Master i Arteve”, “Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë”, “Diplomë e Nivelit të Dytë”, “Diplomë Master Ekzekutiv”, “Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për programin e studimit që ka zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përfundimin e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës”, apo diplomë nga një program studimi të barasvlefshëm të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga Ministria përgjegjëse e arsimit në Shqipëri;
- b) Të ketë notë mesatare të përgjithshme në studimet e ciklit të parë jo më pak se 8.00 dhe notë mesatare të përgjithshme në studimet e ciklit të dytë jo më pak se 8.00, ndërsa për studimet e kryera jashtë vendit të ketë fituar jo më pak se 80% të pikëve totale nga vlerësimi përkatës në studimet e ciklit të parë dhe jo më pak se 80% të pikëve totale nga vlerësimi përkatës për studimet e ciklit të dytë;
- c) Të ketë të mbrojtur me test ndërkombëtar një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, të paktën në nivel B2. Nëse individit ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- d) Të ketë dy rekomandime prej personelit me titull akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- e) Të mos ketë aktualisht masa disiplinore ndaj tij në institucionin e arsimit të lartë, apo në institucionin e kërkimit bazë ose të zbatuar ku kandidati është i angazhuar;
- f) Të mos jetë gjetur në shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave mbi plagjaturën;
- g) Të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor.

Kritere specifike

Të ketë perfunduar studimet e larta dhe te zotërojë të paktën njëren nga diplomatat “Master i Shkencave”, “Master i Arteve”, “Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë”, “Diplomë e Nivelit të Dytë”, “Diplomë Master Ekzekutiv”, “Diplomë e lëshuar në Republikën e Shqipërisë për

programin e studimit që ka zgatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në pershtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës”, ose diplomë ekuivalente me to, në fushën e Ekonomisë/Turizmit ose në fusha të ngjashme dhe/ose të nderlidhura me fushën e Doktoratës, si në:

- Shkenca shoqërore (Psikologji, Sociologji, Drejtësi, Gjeografi, Media dhe Komunikimi);
- Shkenca Humane dhe Arte (Histori, Gjuhët e huaja, Artet);
- Shkenca natyrore (Shkenca e biologjisë Shkenca mjedisore, Shkenca kompjuterike);
- Shkenca e shëndetit

II. Kush mund të aplikojë në programin 'Dokorate' në 'Ekonomi dhe Turizem i Qëndrueshem':

Studimet e Doktoratës ofrohen për ato kandidatë që janë të punësuar si personel akademik-kërkimor në një IAL dhe si personel kërkimor në një institucion kërkimor.

Kane prioritet:

1. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Shkodrës;
2. Personeli akademik me kohë të pjesshme, i Fakultetit Ekonomik të USH-se;
3. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në Departamentet e Fakulteteve të USH-së;
4. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme në Departamentet e Fakulteteve të USH-së
5. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera publike dhe jopublike;
6. Personel akademik me kohë të pjesshme i Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera publike dhe jopublike
7. Punonjës të institucioneve dhe organizatave publike dhe jopublike, që përfshihen në kërkim bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të Doktoratës.

III. Dokumentacionin që kërkohet për aplikim në programin “Dokoratë” në 'Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshem' si më poshtë:

A. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Curriculum Vitae me foto personale;
2. Letër motivimi;
3. Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës dhe dy fotografi;
4. Vertetim për adresesën/rezidencën e banimit;
5. Kopje e noterizuar të diplomave dhe listes së notave të studimeve ose çertifikata të njehsimit të tyre nga Ministria e arsimit në Shqipëri;
6. Dëshmi e gjuhës së huaj (kopje e noterizuar) që verteton plotësimin e kriterit për gjuhën e huaj;

7. Dy rekomandime prej personelit që gezon titull akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
8. Vertetim nga qendra e punës dhe vërtetim page që vërteton kandidati është i punësuar personel akademik pranë një IAL, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar;
9. Propozimi i kandidatit për projekt kërkimit shkencor të tij i cili duhet të jetë në përputheje me fushën e kërkimit shkencor dhe projektet e kërkimit shkencor dhe të zhvillimit të miratuara dhe të publikuara nga njësia përgjegjëse e kësaj Doktorate, ku kandidati të përcaktojë nevojën për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi, metodologjia kërkimore që do të ndiqet, plani i punës kërkimore shkencore i ndarë në vite, si dhe mundësia që studimi të mbulohet nga grante kërkimore-shkencore.
10. Deklaratë e gatishmërisë së udhëheqësit shkencor për të udhëhequr kandidatin;
11. Vertetim nga institucioni ku aderohet si pedagog ose kërkues shkencor që nuk ka masa disiplinore në fuqi.
12. Vetëdeklarim të mos pasjes së ndonjë shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronsia intelektuale apo të mos shkeljes së rregullave mbi plagjiaturën
13. Vetëdeklarim i kandidatit se është në gjendje dhe do të zbatojë standardet shkencore dhe etike të kërkimit shkencor e publikimit;
14. Deklaratë vetjake e kandidatit për perballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës nëse do të financohet;
15. Mandat pagese për tarifen e aplikimit në ALL.
- B. Dorezimi i dosjes së aplikimit me dokumentacionin e duhur, bëhet pranë Sekretares së Dekanit të Fakultetit Ekonomik duke mbajtur proces-verbal për dokumentacionin e dorezuar. Aplikimet pranohen çdo ditë pune në orarin e shpallur në thirrjen për aplikim.
- IV. Ky vendim, pas miratimit përfundimtar nga Dekanati i FEUNISHK, të reflektohet në faqen web të UNISHK dhe ambientet publike të fakultetit ekonomik.

**Dekani i Fakultetit Ekonomik
Prof As Dr Elidhna Bashi**



(Shtojca nr 2)

FUSHË KRYESORE KËRKIMI SHKENCOR: Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm
NËNFUSHAT E KËRKIMIT SHKENCOR:

- Menexhimi i turizmit të qëndrueshëm
- Planifikimi strategjik i avancuar i destinacioneve turistike
- Ekonomiksi i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit
- Ruajtja dhe menxhimi i biodiversitetit për turizëm
- Sistemet e informacionit në turizëm
- Ekonomiksi i ambjentit në turizëm
- Turizmi detar
- Turizmi i verdhë
- Sipërmarrja sociale dhe inovacioni në turizëm
- Restaurim i qendrave urbane dhe i peisazhit historik për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm
- Rikuperimi dhe rijetëzimi i monumenteve për zhvillim turizmi të qëndrueshëm
- Menaxhimi i pasurisë kulturore për zhvillim turizmi të qëndrueshëm
- Menexhimi i kanalit të shpërndarjes në mikpritje
- Diskursi në turizëm



PROJEKTET KËRKIMORE – SHKENCORE DHE TË ZHVILLIMIT PËR DOKTORATËN "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM"

(Shtojca nr 3)

1. Planifikimi strategjik i avancuar i destinacioneve turistike
2. Menaxhim i projekteve
3. Menaxhim Turizmi i Qëndrueshëm
4. Ekonomiksi i zhvillimit të qëndrueshëm
5. Sipërmarrja sociale dhe inovacioni
6. Sistemet e informimit në turizëm
7. Ruajtja dhe menaxhim i biodiversit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Fakulteti Ekonomik

Programi i studimit Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm"

**LISTA E PERSONELIT AKADEMIK TË KATEGORISË "PROFESOR", NË
MBËSHTETJE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
DOKTORATURË NË "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM"**

(Shtojca 4)

Nr.	Emri/Mbiemri	Titulli Akademik	Adresë email
1.	Arjeta Troshani	Prof .dr	arjeta.troshani@unishk.edu.al
2.	Mirjam Dibra	Prof as dr	mirjam.dibra@unishk.edu.al
3.	Brilanda Bushati	Prof as dr	brilanda.bushati@unishk.edu.al
4.	Fatbardha Molla	Prof dr	fatbardha.molla@unishk.edu.al
5.	Blerta Dragusha	Prof dr	blerta.dragusha@unishk.edu.al
6.	Elidiana Bashi	Prof as dr	elidiana.bashi@unishk.edu.al
7.	Ermira Kalaj	Prof dr	ermira.kalaj@unishk.edu.al
8.	Albana Boriçi	Prof as dr	albana.boriçi@unishk.edu.al
9.	Ardita Boriçi	Prof as dr	ardita.boriçi@unishk.edu.al
10.	Alma Hafizi	Prof as dr	alma.hafizi@unishk.edu.al
11.	Entela Hoxhaj	Prof as dr	entela.hoxhaj@unishk.edu.al
12.	Irma Baraku	Prof as dr	irma.baraku@unishk.edu.al
13.	Anila Dizdari	Prof as dr	anila.dizdari@unishk.edu.al
14.	Adem Bekteshi	Prof dr	adem.bekteshi@unishk.edu.al
15.	Edlira Bushati	Prof as dr	edlira.bushati@unishk.edu.al
16.	Dhurata Hoxha	Prof as dr	dhurata.hoxha@unishk.edu.al
17.	Fatbardha Osmanaga	Prof as dr	fatbardha.osmanaga@unishk.edu.al
18.	Medjon Hysenaj	Prof as dr	medjon.hysenaj@unishk.edu.al
19.	Anila Neziri	Prof dr	anila.neziri@unishk.edu.al
20.	Marash Rakaj Ariana Laçaj (Striniqi) (bashkëudhëheqje)	Prof as dr Prof as dr	marash.rakaj@unishk.edu.al ariana.lacej@unishk.edu.al

**MODELI I PARAQITJES SË PROJEKT-PROPOZIMIT KËRKIMOR TË
KANDIDATIT PËR DOKTORANTË NË
'EKONOMI DHE TURIZËM TË QËNDRUESHËM'**

1. **Fusha e përzgjedhur e kërkimit** (nga fushat e miratuara të kërkimit në aplikimin e programit të Doktoraturës- I bashkangjiten lista e fushave të miratuara të kërkimit)
2. **Udhëheqësi shkencor** i propozuar (nga lista që i bashkangjitet për 14 pedagogët e kategorisë 'Profesor' si mbështetës të programit të Doktoraturës me udhëheqje shkencore të studentëve doktorantë)
3. **Përshkrimi i situatës aktuale** (Përshkrim i situatës aktuale të fushës kërkimore, konteksti dhe hapsira e zhvillimit të kërkimit dhe arsytimi që justifikon nevojën e ndërmarrjes së këtij projekt propozimi kërkimor- deri 500 fjalë)
4. **Pyetja kërkimore, qëllimi dhe objektivat e kërkimit** (Evidentim i qartë i pyetjes/pyetjeve kërkimore, i qëllimit të kërkimit dhe listimi i objektivave kërkimore)
5. **Rishikim i literaturës** (max 1 faqe)
6. **Metodologjia e kërkimit të projekt propozimit** (Përshkrim i metodologjisë së kërkimit shkencor)
7. **Rezultatet e pritshme dhe risitë e projekt propozimit** (Rezultatet e lidhura me objektivat e kërkimit, risitë dhe kontibuti akademik dhe praktik i pritshëm i studimit kërkimor)
8. **Biblografia dhe web-biblografia**